



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

INFORMACION LIDHUR ME PROVIMIN E SHTETIT NË PROFESIONET E RREGULLUARA

Provimi i Shtetit në profesionet e rregulluara zhvillohet përmes teknologjisë digjitale pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) me adresë “Bulevardi Zhan D’Ark, Nr. 23, Tiranë, ish ATSH”.

Programet orientuese dhe fondet e pyetjeve të provimit të shtetit në profesionet e rregulluara gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, në adresën www.qsha.gov.al.

Përpara fillimit të çdo sezoni të provimit të shtetit, në faqen zyrtare të QSHA-së publikohet njoftimi i cili përmban të gjithë informacionin e nevojshëm mbi aplikimin dhe procedurat e provimit.

Aplikimi për pjesëmarrje në provimin e shtetit në profesionet e rregulluar kryhet vetëm online nëpërmjet portalit Qeveritar e-Albania, duke përdorur shërbimin “Aplikim për provim shteti”. Kandidati aplikon për pjesëmarrje në provimin e shtetit, duke ngarkuar dokumentet e mëposhtme:

1. *Diplomën/diplomat e programit të studimeve për profesionin/profilin respektiv;*
** Në raste të caktuara: Vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rast kur studimet janë përfunduar jashtë shtetit); Dokumentacion të lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlefshëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur; Dokument që vërteton vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuara;*
2. *Dëshminë e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale të lëshuar nga Urdhri Profesional/ ZVAP, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja;*
3. *Vetëm pas njoftimit të pranimit nga Urdhri Profesional ose DRAP, fatura e pagesës së kryer për llogari të QSHA-së, ngarkohet në sistem në fushën që shfaqet pas vendosjes së kodit të gjurmimit dhe kodit të sigurisë , brenda 72 orëve nga njoftimi i pranimit. Fatura e pagesës e cila gjendet në linkun: <https://qsha.gov.al/fatura-per-arketim/> duhet të ruhet në formatin PDF me emërtesën “Pagesa”.*

Lidhur me aplikimin e shtetasve të huaj, pas zgjedhjes së shërbimit “Aplikim për provim shteti” në portalin Qeveritar e-Albania, zgjidhet opsioni “shtetas i huaj” dhe plotësohen me saktësi fushat e përcaktuara.

Pranimi ose refuzimi i kandidatëve për pjesëmarrje në provimin e shtetit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në sistem dhe verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore, është përgjegjësi e institucioneve kompetente. Për profesionin e rregulluar të Mësuesit është përgjegjësi e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) dhe i nënshtrohet konfirmimit nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), ndërsa për profesionet e tjera të rregulluara është përgjegjësi e Urdhrave Profesionale.

Vetëm aplikimet e pranura nga institucionet kompetente, kalojnë në Sistemin e Provimit të Shtetit për shqyrtimin e pagesës dhe pranimin për pjesëmarrje në provim nga QSHA.

Kandidati njoftohet nëpërmjet postës elektronike, si dhe portalit e-Albania në rubrikën “Hapësira ime – Mesazhet e mia”, në çdo hap të procedurës dhe mund të gjurmojë në çdo kohë statusin e aplikimit me anë të kodit të gjurmimit, duke respektuar afatet e përcaktuara për çdo fazë të aplikimit, deri në publikimin e kalendarit dhe orarit të pjesëmarrjes në provim në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al.

Për çdo problematikë lidhur me aplikimin, kandidatët duhet t’i drejtohen Urdhrit Profesional ose ZVAP/DRAP. Çdo problematikë tjetër që lidhet me procedurat e provimit të shtetit mund të përcillet në adresën info@qsha.gov.al.

PËRGJEGJËSITË E KANDIDATIT PËR ZHVILLIMIN E PROVIMIT TË SHETIT

1. Nëse një kandidat nuk paraqitet në provimin e shtetit ose tërhiqet përpara fillimit të tij, atëherë provimi vlerësohet i pa kryer.
2. Tërheqja nga provimi i shtetit nuk mund të kryhet pas procesit të shpërndarjes së tezës së provimit të shtetit. Në rast se kandidati tërhiqet pas fillimit të provimit, në përfundim të tij ai duhet të firmosë deklaratën me rezultatin e marrë.
3. Kandidati që del nga salla e provimit gjatë kohës së zhvillimit të provimit, nuk do të rihyjë në sallë deri në përfundim të tij.
4. Në rastet kur kandidati tërhiqet përpara fillimit të provimit, tarifa e paguar për provimin e shtetit është e pakthyeshme. Tarifa parapaguhet para ofrimit të shërbimit me përfitues Qendrën e Shërbimeve Arsimore, sa herë që kandidati kërkon t’i nënshtrohet provimit të shtetit.

5. Gjatë zhvillimit të provimit kandidati duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:

- a) ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit gjatë procedurave të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- b) ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të provimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- c) ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e provimit;
- d) ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit.

Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi (Kartë identiteti ose Pasaportë, dokumenti origjinal).

Për çdo seancë provimi, pyetjet e përzgjedhura nga sistemi në mënyrë të rastësishme janë të njëjta për të gjithë kandidatët pjesëmarrës. Provimi zgjat 60 minuta dhe vlerësimi kryhet në mënyrë automatike nga sistemi kompjuterik. Kandidati nuk largohet nga salla e provimit pa firmosur procesverbalin e pjesëmarrjes dhe rezultatit të marrë.

Pas përfundimit të provimit të shtetit, kandidati ka të drejtë të verifikojë përgjigjet e dhëna dhe të ankimojë rezultatin, duke paraqitur pyetje me përmbajtje konkrete, si dhe argumentimin e pretendimit për çdo rast. Ankesa me shkrim përcillet në rrugë postare, pranë QSHA-së, brenda 10 ditëve nga data e dhënies së provimit.

Provimi i shtetit cilësohet i kryer me sukses, nëse në provim kandidati është vlerësuar së paku 50 pikë. Kur provimi i shtetit është kryer me sukses, nuk lejohet të përsëritet. Provimi gjatë sezonit përkatës mund të jepet nga kandidati vetëm një herë.

Kandidatët e suksesshëm në provimin e shtetit, menjëherë pas përfundimit të provimit mund të pajisen me vërtetim të rezultatit, duke përdorur shërbimin “Vërtetim për rezultatin e provimit të shtetit”, i cili ofrohet vetëm online nëpërmjet portalit e-Albania.

JU UROJMË SUKSESE!